



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Nr-4-111- 4 0500

Datë: 27.07.2017

Në mbështetje të Ligjit të Arsimit Parauniversitar nr. 04/L-032, neni 35 Ligjit për Vetëqeverisje lokale nr. 03/L040 të datës 20 Shkurt 2008, Ligjit për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068 të datës 21 Maj 2008 dhe Udhëzimit Administrativ 08/2014 të datës 25.02.2014, Drejtoria Komunale e Arsimit në Lipjan, shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës

- Drejtor në ÇEAP "Çerdhja" në Lipjan
- Drejtor në SHMLM-Mikse në Shalë

Detyrat e punës: të planifikojë, organizojë dhe bashkërendisë punën e përgjithshme në shkollë. Në bashkëpunim me MASHT-in, DKA-në, merr vendime të ndryshme që kanë të bëjnë me funksionimin e punës në shkollë.

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs:

1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
 - 1.1. Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240ECTS/4 vite të shkollimit universitar) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore,
 - 1.2. Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit ose të jetë në procedurë të Licencimit,
 - 1.3. Të kenë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim.
2. Të kenë së paku 3 vjet përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit.

Gjithashtu kandidatët duhet të posedojnë këto dokumente:

3. Certifikata e lindjes,
 - 3.1. Diploma e fakultetit të kryer për nivelin përkatës,
 - 3.2. Dëshmi për përvojën e punës,
 - 3.3. Portfolion profesionale,
 - 3.4. Letër referencë nga një institucion publik-kredibil (si Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, DKA, Këshilli Drejtues i shkollës, punëdhënësi paraparak si dhe nga institucionet e arsimit të lartë),

- 3.5. Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën paraprake,
- 3.6. Planin zhvillimor të institucionit edukativo - arsimore dhe aftësuese për të cilin ka konkurruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12, Arial) sipas udhëzimeve të MASHT-it,
- 3.7. Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilin dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore,
- 3.8. Dëshmi se nuk është nën hetime.

Koeficienti i pagës : Drejtor në ÇEAP-Çerdhe: 7.2
Drejtor në SHML: 8.4

- Kohëzgjatja e kontratës së punës:** Katër (4) vite duke përfshirë periudhën tremujore provuese.
- Aplikacionet merren në ndërtesën e KK në Lipjan, në Qendrën për shërbime të qytetarëve sporteli nr. 3 dhe dorëzohen në të njëjtin vend,
 - Kërkesat e arritura pas afatit nuk do të pranohen,
 - Kërkesat e pakompletuara refuzohen, nuk shqyrtohen,
 - Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet ligjore.
 - Afati i konkursit është 15 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor,
 - Shërbimi Civil i Kosovës i shërben gjithë popullit të Kosovës dhe mirëpret Kërkesat (aplikacionet) prej meshkujve dhe femrave nga të gjitha komunitetet e Kosovës.

Drejtori i DKA-së
Rasim Hasani

